



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Sharr Morina BI" të datës 26.12.2025 kundër njoftimit të AK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Trajnimi dhe furnizimi për identifikimin e parasë së falsifikuar" me nr. të prokurimit 616-25-5312-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. MIRATOHET si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Sharr Morina BI" të datës 26.12.2025 kundër njoftimit të AK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Trajnimi dhe furnizimi për identifikimin e parasë së falsifikuar" me nr. të prokurimit 616-25-5312-1-2-1 ashtu që ANULOHEM njoftimi B08 për dhënie të kontratës i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.**
- II. DETYROHEM autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në RIVLERËSIM aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.**
- III. NJOFTOHEN palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.**
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.**

Arsyetim

Operatori ekonomik "Sharr Morina BI" (tutje "parashtruesi") me datë 26.12.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit B08 për dhënie lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Trajnimi dhe furnizimi për identifikimin e parasë së falsifikuar" me nr. të prokurimit 616-25-5312-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtresit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtuar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtresit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritot (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: "Neni 56 pika 1.1 - AK na ka eliminuar / përjashtuar nga gara per nje dokument qe nuk eshte kerkuar ne DT. Kontrata nuk eshte kerkuar ne DT por jane kerkuar vetem Nje liste e kontratave (Lista sipas aneks 6) dhe referencat per realizimin e kontratave".

Fillimisht duhet sqaruar që AK nuk ka publikuar fare B58 Njoftimin mbi Vendimin e AK. Po ashtu nuk janë bashkëngjitur as letrat standarde për tenderuesit. Një veprim i tillë përbën shkelje flagrante të nenit 55.35 lidhur me nenin 42.1 dhe 21.4 nënpar. b) të RRPP.

Sa i përket pretendimeve ankimore, është gjetur se në DT është kërkuar që tenderuesit të dorëzojnë një listë të kontratave të ngjashme të realizuara në 3 vitet e fundit para njoftimit për kontratë si dhe referencat për kontratat e prezantuara në atë listë, mirëpo nuk janë kërkuar edhe kontratat si të tilla. Në anën tjetër është gjetur se parashtruesi në ofertën e tij ka dorëzuar edhe listën edhe referencat.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 31.12.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.